

## AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Në Durrës, sot në datën 19/Prill/2022, une Michele Sassanelli, atësia Giacomo, shtetas Italian, lindur në Bari, Itali dhe banues në Shqipëri, në adresën rruga Taulantia, lagja nr. 1, pallati Kastrati, me adresë Itali, Palermo (Carbonara) 34 Bari, lindur më 30/08/1983, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, pajisur me Leternjoftim ID nr. CA59537DG dhe nr. personal CA59537DG, bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i azhornuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” etj, **themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar “JOY CALL” sh.p.k.**

**Selia** e shoqërisë është në Durrës, në adresën lagja nr. 11, rruga “Agostin Serreqi”, Pallati ngjitur me shkollën “Shaqe Mazreku”, kati i dyte.

**Objekti** i shoqërisë është: Te ofroje një linje telefonike ndihme shumëgjuhëshe për klientin dhe shërbim suporti për çdo aktivitet dhe shërbim, te ofrojë shërbime tregtare dhe aktivitete mbështetëse. Te kryeje te gjitha veprimtaritë tregtare dhe zbatoje çdo mase për promovimin e drejtpërdrejtë ose te tërthorte te objektit te sipërpërmendur. Ne mënyre qe te përmbushë objektin e mësipërm, Shoqëria ka te drejte te lidhe çdo lloj kontrate apo marrëveshje me persona fizike ose me ente private apo publike, shoqëri, qeverinë dhe organizata te huaja ose shqiptare, Te themeloje shoqëri te çdo lloji ose te behet pjese shoqërive shqiptare ose te huaja, ndërmarrjeve te përbashkëta ose lloje te ndryshme biznesesh me objekt te njëjte ose te ngjashëm;

Te themeloje dege apo agjenci ne Shqipëri ose jashtë saj; Te përfaqësoje biznese shqiptare ose te huaja te lidhura me objektin e Shoqërisë; Te marre ose japë hua, te pranoje garanci personale ose garanci te tjera, te marre përsipër detyrime, te lëshojë kambiale, urdhërpagesa, ceqe ose obligacione ose garanci ose tituj dhe te emetoje garanci te tjera financiare; Te ndërmarrë çdo veprimtari tjetër

tjetër ligjor ose transaksion qe lidhet direkt ose indirekt me objektin e Shoqërisë ose qe synon ne mënyre te drejtpërdrejte apo te tërthorte përmbushjen e objektit te Shoqërisë. Shoqëria mund te kryeje ne mënyrë dytësore, pra rastësore dhe jo te drejtpërdrejtë, me qellim përmbushjen e objektit te Shoqërisë. Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit nr. 9901, dt.14.04.08

**Kohëzgjatja** e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është **pa afat**.

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 1'000 (një mijë) lekë, i përbërë nga 1 kuotë, me 100 % pjesëmarrje dhe do të zotërohet nga unë ortakut i vetëm themelues Michele Sassanelli**

Shoqëria do të shtrijë aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë. Me Vendim të Asamblesë së përgjithshme mund të ndryshohet, krijohen ose anulohen në rast se janë çelur, Seli, Filiale, Agjenci dhe perfaqësi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë.

**Administrator i shoqërisë emërohet z. Michele Sassanelli, i cili deklaron se pranon rolin e ngarkuar dhe se nuk ekzistojnë shkaqe të ligjshme që mund ta shpallin të pavlefshme.**

**Afati i emërimit të administratorit është pesë vjet.** Administratori emërohet sot në datën e nënshkrimit të aktit të themelimit. Emërimi i prodhon efektet pas regjistrimit ne Qendrën Kombetare të Regjistrimit (Neni 95, pika e parë e Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”)

**Administratori përfaqëson shoqërinë tregtare, kryen veprimtarinë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politika tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.**

Në rastet e kryerjes së veprimtarive të rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe që lidhen me transaksione të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo çdo lloj tjetërsimi të tyre, zmadhime të kapitalit themeltar, venie garancie hipotekore apo bankare, marrje kredie, marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombetare, Administratori i emëruar kryen veprime bankare vetëm mbi bazën e Vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, i cili duhet të jetë legalizuar nga Noteri.

Pjesët e kapitalit themelor janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie ligjore ose testamentare sipas dispozitave të Kodit Civil. Ortaku gëzon të drejtën e shitjes se kuotave jashtë ortakërisë mbi bazen e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas procedurave që janë përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Ky Akt Themelimi redaktohet në tre njësi origjinale, me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet me zë miratohet nga unë ortaku i vetëm themelues.

ortaku i vetëm themelues

MICHELLO SASSANONE 